

20252695197

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIMIN
PENSIONAL DHE INVALIDOR**

Neni 1

Në Ligjin e Sigurimit Pensional dhe Invalidor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 98/12, 166/12, 15/13, 170/13, 43/14, 44/14, 97/14, 113/14, 160/14, 188/14, 20/15, 61/15, 97/15, 129/15, 147/15, 154/15, 173/15, 217/15, 27/16, 120/16, 132/16, 27/18, 35/18, 220/18 dhe 245/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut " numër 180/19, 275/19, 31/20, 267/20, 67/22, 79/23, 193/24, 75/25 dhe 154/25), në nenin 11 paragrafi (1) pika 15) ndryshohet si vijon:

"persona të angazhuar me punë për kryerjen e punëve me natyrë të përkohshme ose sezonale në përputhje me ligjin."

Në paragrafin (2) pas numrit "9" presja zëvendësohet me lidhëzën "dhe", ndërsa fjalët: "edhe 15" shlyhen.

Neni 2

Në nenin 30 pas numrit "5" lidhëza "dhe" zëvendësohet me presje, ndërsa pas numrit "6" shtohen fjalët: "edhe 15".

Neni 3

Në nenin 31, në paragrafin (2), fjalët: "dhe për një person fizik që është i regjistruar si kryerës i veprimtarisë së pavarur për tregti me pakicë në tezga dhe tregje" shlyhen.

Neni 4

Në nenin 50 paragrafi (1) në fjalinë hyrëse fjala "të caktuara" zëvendësohet me numrin "50".

Neni 5

Në nenin 118, në paragrafin (1), fjalët: „pikat 9) dhe 15) zëvendësohet me fjalët: "pika 9)".

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

"(2) Personat e siguruar nga neni 11, pika 15) të këtij ligji, të cilët ishin anëtarë të shtyllës së dytë të pensioneve, pas punësimit për kryerjen e punës me natyrë të përkohshme ose sezonale, do të vazhdojnë anëtarësimin e tyre në fondin e detyrueshëm të pensioneve, me përjashtim të përfituesve të pensionit të moshës dhe pensionit familjar, i/e vejë dhe prindër."

Paragrafët (2) dhe (3) bëhen paragrafët (3) dhe (4).

Në paragrafin (4) i cili bëhet paragrafi (5) fjalët: "(2) dhe (3)" zëvendësohen me fjalët: "(3) dhe (4)", ndërsa fjalët: "pikat 9) dhe 15)" zëvendësohen me fjalët: "pika 9)".

Në paragrafin (5) që bëhet paragraf (6) fjalët: "(2) dhe (3)" zëvendësohet me fjalët: "(3) dhe (4)".

Neni 6

Në nenin 125 paragrafi (4) në pikën 6) fjalët: "Dhoma e tregtarëve të Maqedonisë" zëvendësohen me fjalën "punëdhënësi".

Neni 7

Pas nenit 132-a shtohet neni i ri 132-b, si vijon:

“Neni 132-b

(1) Procedura për ushtrimin e të drejtave nga sigurimi pensional dhe invalidor zhvillohet në formë elektronike me formimin e lëndës elektronike, duke përdorur softuerin e Fondit për zgjidhjen dhe pagesën elektronike të pensioneve.

(2) Të gjitha dokumentet e bashkangjitura në dosje skanohen në procedurë dhe janë pjesë integrale e lëndës elektronike.

(3) Kur në procedurë përcaktohet se personi i siguruar ka të drejtë për pension, por për shkak të zgjidhjes së një çështjeje të mëparshme nuk mund të merret një vendim përfundimtar, Fondi, me një vendim të përkohshëm, përcakton që personit të siguruar t'i paguhet një pagesë paraprake e të ardhurave në një shumë të përcaktuar në bazë të të dhënave që ka në dispozicion.

(4) Fondi merr vendim përfundimtar sipas detyrës zyrtare pas zgjidhjes së çështjes së mëparshme, dhe në rastin e vendimeve të përkohshme të miratuara për shkak të mungesës së koeficientëve për vlerësimin e pagave, vendimi përfundimtar merret brenda 30 ditëve nga dita e publikimit të koeficientëve për vlerësimin e pagave.

(5) Dorëzimi i vendimit nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni bëhet me postë të regjistruar me një fletëdërgesë.”.

Neni 8

Në nenin 134 në paragrafin (2) pas fjalës “vendimi” vihet pikë dhe teksti deri në fund të fjalisë shlyhen.

Neni 9

Në nenin 148, në paragrafin (1), fjalët: “Ose vend të huaj” shlyhen.

Pas paragrafit (2) shtohet paragraf i ri (3) si vijon:

“(3) Si përjashtim nga paragrafi (1) i këtij neni, pagesa e pensionit nuk pezullohet për përfituesit e pensionit të moshës dhe përfituesit e pensionit të të mbijetuarve që janë të angazhuar në punë me natyrë të përkohshme ose sezonale në përputhje me ligjin.”

Neni 10

Në nenin 199 paragrafi (1) pika 7 ndryshohet si vijon:

“punëdhënësit e personave që janë të angazhuar për të kryer punë me natyrë të përkohshme ose sezonale në përputhje me nenin 11 paragrafi (1) pika 15) të këtij ligji.”.

Neni 11

Në nenin 209 paragrafin 1 në pikën 7) lidhja “dhe” në fund të fjalisë zëvendësohet me pikëpresje.

Në pikën 8) pika në fund të fjalisë zëvendësohet me lidhëzën “dhe”.

Pas pikës 8) shtohet pikë e re 9) , si vijon:

“9) të dhënat mbi fillimin, pra përfundimin e sigurimit dhe ndryshimet gjatë rrjedhës së sigurimit për personat që janë të punësuar për të kryer punë me natyrë të përkohshme ose sezonale duhet të ofrohen në baza ditore ose për një muaj kalendarik.”.

Neni 12

Në nenin 210 paragrafi (1) në pikën 1) fjalët: “1 dhe 2” zëvendësohet me fjalën: “1,2 dhe 9”.

Neni 13

Ky ligj hyn në fuqi me ditën e botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut, përveç dispozitave të neneve 1, 2, 3, 5, 6, 9, 10, 11 dhe 12 të këtij ligji të cilat do të fillojnë të zbatohet nga 1 janari 2026.